



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 5/2023 regjistër (JR)  
Datë 03.02.2023

Nr. 16 i vendimit  
Datë 19.04.2023

**V E N D I M**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Natasha</b>	<b>Mulaj</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ina</b>	<b>Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana</b>	<b>Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza</b>	<b>Tasi</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 19.04.2023, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Eugen Papandile, këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese.

**OBJEKTI:** Prishjen e vendimit nr. 591, datë 23.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe lënien në çmim të gjyqimit përfundimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për pushimin e gjyqimit dhe ndërprerjen e procesit të rivlerësimit apo vazhdimin e rivlerësimit dhe hetimit administrativ.

**BAZA LIGJORE:** Neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkesave të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili kërkoi përfundimisht prishjen e vendimit nr. 591, datë 23.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe lënien në çmim të gjykimit përfundimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për pushimin e gjykimit dhe ndërprerjen e procesit të rivlerësimit apo vazhdimin e procesit të rivlerësimit dhe hetimit administrativ, dëgjoji gjyqtaren relatores Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Eugen Papandile ka ushtruar funksionin e këshilltarit ligjor të Gjykatës Kushtetuese në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, deri më datë 31.12.2017. Bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe nenin 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, ndaj tij ka nisur procesi i rivlerësimit *ex officio* prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”).
2. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2017, z. Eugen Papandile i ka paraqitur Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese aktin “Kërkesë për punësim”, me të cilin shpreh interesin për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj gjykate, si dhe ka paraqitur bashkëlidhur dokumentet e nevojshme për të provuar plotësimin e kriterëve ligjorë të kërkuara në njoftimin e publikuar në hapjen e garës për këtë pozicion pune. Mbi bazën e kësaj kërkesë dhe të vlerësimit të bërë nga komisioni i shqyrtimit të kandidatave, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.12.2017, i propozon Mbledhjes së Gjyqtarëve të kësaj gjykate, kandidaturën e z. Eugen Papandile për t’u emëruar në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.12.2017, ka vendosur emërimin e z. Eugen Papandile në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj gjykate, duke përcaktuar hyrjen në fuqi të këtij vendimi më datë 01.01.2018.
3. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njoftuar për nisjen e procesit të tij të rivlerësimit, me anë të postës elektronike në datën 07.07.2021, ka komunikuar me Komisionin në datën 21.07.2021, duke pretenduar, ndër të tjera, se ai nuk është subjekt i ligjit nr. 84/2016, pasi: **(i)** nga data 01.01.2018 ushtron funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese, funksion i cili nuk është i parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës si funksion që rivlerësohet *ex officio*, duke shpjeguar se në këtë funksion është zgjedhur mbi bazën e vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve të kësaj gjykate, dhe se nuk ka dhënë dorëheqjen nga detyra e mëparshme e Këshilltarit Ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese; **(ii)** i është nënshtruar procesit të vlerësimit nga KED-ja dhe ka kaluar me sukses vlerësimin për të qenë kandidat për konkurrimin në pozicionet e lira për funksionin gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese; **(iii)** duke qenë në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm, që është grada më e lartë e shërbimit civil në Institucion, nuk mund të merrte pjesë në testimin e Shkollës së Magjistraturës dhe, për këtë arsye, objekti për të cilin Komisioni do të nisë punën bëhet i pamundur. Në komunikimin e datës 21.07.2021, subjekti i rivlerësimit nuk është shprehur lidhur me qenien ose jo në kushtet e konfliktit të interesit

me anëtarët e trupës gjyquese të Komisionit dhe as ka përcjellë të plotësuar pyetësorin standard që i kishte vënë në dispozicion Komisioni në funksion të hetimit administrativ të nisur për të.

4. Pas këtij komunikimi me subjektin e rivlerësimit, Komisioni ka kërkuar: **(i)** përcjelljen nga Gjykata Kushtetuese të gjithë praktikës së emërimit të subjektit të rivlerësimit Eugen Papandile në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj gjykate; **(ii)** informacion nga Shkolla e Magjistraturës, nëse subjekti i rivlerësimit ka kryer testimin si jo magjistrat pranë saj; **(iii)** informacion nga KED-ja lidhur me vlerësimin e kandidaturës së z. Eugen Papandile për t'u zgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.
5. Pas administrimit të informacionit të mësipërm, Komisioni, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 15.11.2022, ka vendosur: *“Për mbylljen e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Eugen Papandile; të njoftojë subjektin për t'u njohur me: provat e administruara nga Komisioni; të drejtat që gëzon nga ligji lidhur me deklarimin e konfliktit të interesit, të drejtën për marrjen e provave dhe thirrjen e dëshmitarëve, si dhe t'i përcjellë subjektit rezultatet paraprake të hetimit administrativ”*.
6. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.11.2022, Komisioni ka vendosur të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore në datën 22.11.2022 dhe këtë vendim ia ka njoftuar me e-mail në të njëjtën datë subjektit të rivlerësimit. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Eugen Papandile u zhvillua nga Komisioni më datë 22.11.2022. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit ishte prezent dhe paraqiti qëndrimin e tij. Trupi gjyqësor i Komisionit shpalli vendimin përfundimtar në seancën publike të datës 23.11.2022, pa praninë e subjektit të rivlerësimit.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

7. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 591, datë 23.11.2022, ka vendosur: *[...] mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 57, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 64, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:*
  1. *Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Eugen Papandile.*
  2. *Ndalimin e emërimit të z. Eugen Papandile si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.*
8. Kundër vendimit nr. 591, datë 23.11.2022, të Komisionit, ka paraqitur ankim subjekti i rivlerësimit, i cili kërkon: *Prishjen e vendimit nr. 591, datë 23.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe lënien në çmim të gjykimit përfundimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për pushimin e gjykimit dhe ndërprerjen e procesit të rivlerësimit apo vazhdimin të rivlerësimit dhe hetimit administrativ.*

## **III. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit**

9. Subjekti i rivlerësimit Eugen Papandile ushtroi ankim ndaj vendimit nr. 591, datë 23.11.2022, të Komisionit, duke pretenduar se ky vendim është marrë në cenim të së drejtës së subjektit për një proces të rregullt ligjor dhe si pasojë e interpretimit të gabuar të statusit të subjektit, sipas Kushtetutës

dhe ligjit nr. 84/2016. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

10. Në drejtim të zbatimit të parimeve të procesit të rregullt ligjor subjekti i rivlerësimit pretendon se: **(i)** seanca dëgjimore prej Komisionit është zhvilluar duke mosrespektuar procedurat për njoftimin e subjektit të rivlerësimit; **(ii)** qëndrimi i komisioneres relatores të Komisionit, shprehur në relacionin para seancës dëgjimore publike se *ushtrimi nga subjekti i rivlerësimit me vullnet të lirë i një detyre tjetër të ndryshme nga ajo që jepte statusin e subjektit të rivlerësimit ex officio, si dhe duke konsideruar se subjekti kërkon të mos i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, është situatë që çmon se Komisioni duhet të ndërpresë procesin e tij të rivlerësimit me ndalimin e tij të emërimit si gjyqtar dhe prokuror për 15 vjet*, konsiderohet nga subjekti si marrje e parakohshme e vendimit prej Komisionit, që tregon se procesi i tij i rivlerësimit ka qenë i paragjykuar nga ky organ; si dhe **(iii)** vendimi i Komisionit cenon parimin e sigurisë juridike, cenon të drejtën private të subjektit dhe ka pasoja të rënda në jetën profesionale.
11. Lidhur me vendimmarrjen e Komisionit, subjekti pretendon se ajo nuk është e drejtë dhe është marrë në zbatim të gabuar të dispozitave të ligjit nr. 84/2016, pasi: **(i)** ka një vlerësim të gabuar të arsyes së largimit të subjektit nga funksioni i këshilltarit ligjor të Gjykatës Kushtetuese në atë të Sekretarit të Përgjithshëm, duke pretenduar se ky largim nuk është bërë për të shmangur procesin e rivlerësimit kalimtar, por për një zhvillim të mëtejshëm në karrierën e tij profesionale. Në funksion të këtij pretendimi, subjekti shpjegon se Komisioni nuk mund, si dhe nuk arrin të provojë faktin që largimi në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm është bërë mbi bazën e dorëheqjes, siç kërkon neni G i Aneksit të Kushtetutës, por është realizuar mbi bazën e vendimmarrjes së Mbledhjes së Gjyqtarëve të kësaj gjykate; **(ii)** duhet të mbahet në konsideratë se moskryerja prej subjektit e testimin nga Shkolla e Magjistraturës nuk është kryer për faj të tij, por për shkak se në momentin kur janë kryer këto teste ai nuk është konsideruar subjekt në detyrë dhe nuk është njoftuar për këtë testim; **(iii)** rivlerësimi i subjektit si ish-këshilltar i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të bëhet nga Komisioni, pasi tashmë kjo ishte gjë e gjykuar nga KED-ja që është një organ tjetër kushtetues i pavarur, duke pretenduar se Komisioni nuk ka pasur kompetencë dhe juridiksion për të kryer procesin e tij të rivlerësimit kalimtar; **(iv)** subjekti i rivlerësimit pretendon se në asnjë rast nuk është shprehur se nuk duhet të vetohet dhe se në vendimin e Komisionit, objekt shqyrtimi, nuk është pasqyruar vullneti i tij për të vazhduar procesin e rivlerësimit; **(v)** në vendimin e Komisionit nuk analizohet, nëse KED-ja do të kishte vendosur për emërimin e subjektit të rivlerësimit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, a do të kishte juridiksion Komisioni për të vlerësuar një gjyqtar në detyrë që në asnjë moment nuk kishte qenë pjesë e kontrollit të këtij organi.

### **Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

#### **A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit**

##### *a) Juridiksioni i Kolegjit*

12. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika

2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin Eugen Papandile dhe ndalimin e emërimit të tij, si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, të cilin subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet ankimit, kërkon ta prishë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

13. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Në drejtim të verifikimit të *ratione temporis*, sipas kërkesave të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.12.2022, i ka dërguar subjektit të rivlerësimit vendimin nr. 591, datë 23.11.2022 dhe aktin “Lajmërim marrje” të nënshkruar nga zj. V. P. më datë 19.12.2022. Ankimi i subjektit të rivlerësimit është administruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 13.01.2023. Në aktet e administruara në fashikull gjendet edhe dokumenti postar i emërtuar “letër shoqërimi dhe pagesë”, i lëshuar nga Posta “{\*\*\*}”, tek i cili në rubrikën “firma e dërguesit” është një nënshkrim me datë 31.12.2022. Nisur nga kjo situatë faktike, Komisioni, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 17.01.2023, i ka kërkuar shpjegime operatorit Postar “{\*\*\*}”, lidhur me kohën e depozitimit të aktit nga dërguesi Eugen Papandile, si dhe ka kërkuar shpjegime për dorëzimin e aktit në Komision 13 (trembëdhjetë) ditë pas depozitimit të këtij akti në postë. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Posta “{\*\*\*}”, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 23.01.2023, konfirmon se akti është dorëzuar nga dërguesi Eugen Papandile pranë zyrave të kësaj poste më datë 31.12.2022, dhe se për shkak të ngarkesës së ditës së fundit të vitit, të ditëve pushim në vijim, si dhe për shkak të neglizhencës, punonjësi i postës ka dorëzuar me vonesë këtë akt në Komision. Posta “{\*\*\*}” shpjegon se fakti i mosdorëzimit në kohë të aktit është evidentuar nga vetë punonjësi përgjegjës, i cili ka njoftuar për këtë pakujdesi, e cila ka shkaktuar marrjen e një mase administrative ndaj tij. Pas korrespondencës së mësipërme, Komisioni ka marrë në shqyrtim ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit Eugen Papandile dhe me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 24.01.2023, ka vendosur pranimin e ankimit si të plotë dhe në përputhje me parashikimet e nenit 46 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”).

13.1 Në analizë të situatës faktike të evidentuar më sipër, lidhur me kohën e paraqitjes së ankimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 591, datë 23.11.2022, Kolegji e konsideron të drejtë pranimin e ankimit nga Komisioni, për sa kohë subjekti ka mundur të provojë me anë të dëftesës së postimit të lëshuar nga posta “{\*\*\*}” se vonesa në paraqitjen e ankimit pranë Komisioni ka ndodhur jo për shkaqe që lidhen me të, por për shkak të keq organizimit të zyrës postare, pranë të cilës është paraqitur ky dokument, dhe se prej tij ankimi është depozituar pranë zyrës postare brenda afatit ligjor.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

14. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 591, datë 23.11.2022, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Eugen Papandile, si rregull u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi.

## B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit

15. Në lidhje me pretendimet e ankimit të subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi ka cenuar parimet e procesit të rregullt ligjor, Kolegji analizon sa vijon.

15.1 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *seanca dëgjimore prej Komisionit është marrë duke mosrespektuar procedurat për njoftimin të subjektit të rivlerësimit*, konstatohet se në vendimin objekt shqyrtimi është cituar se *në seancën dëgjimore të datës 22.11.2022, subjekti pretendoi se nuk ishte njoftuar me e-mail për datën e seancës, por ka marrë dijëni në rrethana të tjera. Komisioni analizoi këtë pretendim të subjektit dhe konstatoi se për arsye subjektive e-mail-i nuk i ishte dërguar subjektit, por njoftimi i datës së seancës dëgjimore ishte bërë publike në të gjitha mënyrat e parashikuara në rregulloren e Komisionit. Sa më sipër, subjekti ushtroi të drejtën e dëgjimit në seancën dëgjimore publike, duke iu garantuar respektimi i procesit të rregullt ligjor.*

15.2 Nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të zhvilluar në Komision rezulton se pasi kryesuesja e seancës dëgjimore në relatimin e saj deklaroi se janë kryer procedurat e njoftimit ka ndërhyrë subjekti duke i bërë me dije se nuk ka pasur njoftim të drejtpërdrejtë nga Komisioni për zhvillimin e seancës dëgjimore, por e ka marrë atë nga persona të tretë. Komisioneria ka vijuar me shpjegimin e procedurave për kryerjen e njoftimit dhe duke vërejtur se mosnjoftimi i tij mund të ketë ardhur për shkak të problemeve që mund të ketë e-mail-i i vetë subjektit<sup>1</sup>. Pas kësaj ndërhyrje të kryesueses së trupës së Komisionit, subjekti ka deklaruar se *mbase [...] (domethënë mbase problemi qëndronte në e-mail-in e tij), por unë thash që nuk kam kërkesa paraprake. Mbase kjo është për t'u verifikuar nga ana teknike, por unë do të vazhdoj seancën, pasi ndryshe do të bëja kërkesë paraprake për shtyrje.*

15.3 Nga sa përshkruar më sipër, Kolegji konstaton se çështja e mosmarrjes njoftim nga subjekti i rivlerësimit është evidentuar përgjatë seancës dëgjimore publike të zhvilluar në Komision nga vetë subjekti si mangësi dhe po vetë ai e ka shëruar këtë rrethanë, duke deklaruar se nuk ka kërkesa paraprake për shtyrje seance për shkak të mosnjoftimit. Nga ana tjetër, Kolegji evidenton se subjekti në ankim për këtë pretendim nuk ka bërë asnjë analizë rreth pasojës që në kuptim të procesit të rregullt ligjor i ka shkaktuar subjektit ky mosnjoftim i drejtpërdrejtë i datës së seancës dëgjimore, për të cilën ishte vënë në dijeni në një kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen, përderisa nuk ka kërkuar shtyrjen e saj për këtë qëllim.

15.4 Në këto kushte, Kolegji konstaton se mosnjoftimi i subjektit për datën e seancës, përveçse nuk pati ndikim në praninë e subjektit në seancën dëgjimore, pasi ai mori pjesë në të, por as nuk u pretendua prej tij si një shkelje që do të cenonte procesin në seancë dëgjimore. Në këto kushte, Kolegji çmon se ngritja në ankim e këtij kërkimi duket një pretendim që thjesht synon vetëm të kundërshtojë vendimin e Komisionit që ka vendosur sanksionin administrativ për subjektin.

15.5 Lidhur me pretendimin e subjektit se qëndrimi në relacionin e Komisionit para seancës dëgjimore publike se *ushtrimi nga subjekti i rivlerësimit me vullnet të lirë i një detyre tjetër të*

---

<sup>1</sup> Subjekti ka deklaruar si adresë elektronike kontakti e-mail-in zyrtar ([eugen.papandile@gjk.gov.al](mailto:eugen.papandile@gjk.gov.al)), i cili, sipas shpjegimeve të subjektit, kur Komisioni i ka dërguar njoftimin nuk ka funksionuar, pasi serveri i Gjykatës Kushtetuese po kalonte në varësi të AKSh-it.

*ndryshme nga ajo që jepte statusin e subjektit të rivlerësimit ex-officio, si dhe duke konsideruar se subjekti kërkon të mos i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, është situatë që çmon se Komisioni duhet të ndërpresë procesin e tij të rivlerësimit me ndalimin e tij të emërimit si gjyqtar dhe prokuror për 15 vjet, konsiderohet nga subjekti si marrje e parakohshme e vendimit prej Komisionit dhe tregon se procesi i tij i rivlerësimit ka qenë i paragjykuar nga ky organ, Kolegji analizon sa vijon.*

**15.6** Nga aktet e administruara në fashikullin e hetimit administrativ rezulton se: (i) Komisioni, me e-mail-in e datës 15.11.2022, i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit raportin (të referuar edhe si rezultate paraprake të hetimit administrativ), në të cilin analizohen elementet që çojnë këtë institucion drejt arsytimit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit të subjektit; (ii) me anë të këtij komunikimi, Komisioni, gjithashtu, i bën me dije subjektit se për rezultatet paraprake të hetimit ka të drejtën të paraqesë prova dhe shpjegime me shkrim brenda datës 18.11.2022.

**15.7** Nga përmbajtja e rezultateve paraprake të hetimit, rezulton se Komisioni i ka përmbyllur ato duke arsyetuar se *në konkluzion sa më sipër, duke qenë se z. Eugen Papandile është duke ushtruar me vullnet një detyrë të re, të ndryshme nga ajo që i jepte statusin e subjektit të rivlerësimit ex officio, si dhe duke kërkuar që të mos i nënshtrohet procesit të rivlerësimit mbështetur në analizën ligjore, rrethanat e çështjes dhe dokumentacionit të administruar, Komisioni çmon se duhet të ndërpresë procesin e rivlerësimit me ndalimin e emërimit të z. Eugen Papandile si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë e Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.*

**15.8** Nga përmbajtja e dokumentit, tek i cili është përfshirë ky qëndrim/vlerësim paraprak i organit rivlerësues, Kolegji vëren se përveçse evidentohet sinteza e linjës së arsytimit dhe të analizës ligjore që Komisioni ka konsideruar gjatë hetimit administrativ është bërë e mundur që subjekti të perceptojë qartë dhe pa ekuivok se cili është konkluzioni i rezultateve paraprake të hetimit, për të cilat subjekti duhet të paraqesë shpjegime dhe analizën ligjore përse i kundërshton ato. Sipas praktikës së deritanishme të veprimtarisë së Komisionit për rastet të ngjashme, kjo procedurë zhvillohet në këtë mënyrë për t'iu mundësuar subjekteve të rivlerësimit që të kundërshtojnë qëndrimet paraprake të Komisionit, nëpërmjet shpjegimeve, provave apo analizës ligjore që ata do bëjnë në përgjigje të këtyre konkluzioneve.

**15.9** Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji çmon se nëse Komisioni në rezultatet paraprake të hetimit do të ishte shprehur në mënyrë të paqartë apo nuk do të kishte identifikuar qartë vlerësimin që ky organ kishte mbi rastin objekt shqyrtimi, atëherë prej subjektit mund të pretendohet se kjo paqartësi e vlerësimit të situatës së tij i ka cenuar apo kufizuar të drejtën për t'u mbrojtur.

**15.10** Për sa më sipër, Kolegji këtë qëndrim të Komisionit e gjen të njëjtë me qëndrimin që ky organ ka mbajtur në raste të ngjashme<sup>2</sup> dhe, për këtë arsye, vlerëson se nuk ka vend për të pretenduar për një standard të ndryshëm të aplikuar në rastin objekt shqyrtimi.

---

<sup>2</sup> *Shih vendimet e Kolegjit: nr. 46/2022 (JR), datë 01.12.2022; nr. 21/2022 (JR), datë 17.06.2022; nr. 32/2021 (JR), datë 14.10.2021; nr. 5/2021 (JR), datë 12.02.2021; nr. 2/2021 (JR), datë 13.01.2021; nr. 32/2020 (JR), datë 23.11.2020 dhe nr. 17/2019 (JR), datë 25.07.2019.*

15.11 Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit cenon parimin e sigurisë juridike, cenon të drejtën private të subjektit dhe ka pasoja të rënda në jetën profesionale, Kolegji analizon sa vijon.

15.12 Duke iu referuar përmbajtjes së ankimit konstatohet se subjekti pretendon se vendimi i Komisionit shkakton cenimin e të drejtës për një jetë private në aspektin e cenimit të veprimtarisë me natyrë profesionale, pasi pamundëson ushtrimin e profesionit të prokurorit, gjyqtarit apo të këshilltarit ligjor. Gjithashtu, subjekti pretendon se kufizimi i të drejtës në ushtrimin e profesionit për një periudhë 15-vjeçare cenon të drejtën ligjore që ai kishte fituar për të qenë pjesë e sistemit gjyqësor.

15.13 Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, Kolegji vëren se Komisioni për z. Eugen Papandile ka konkluduar se ai gëzonte statusin e subjektit të rivlerësimit në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016, që miratoi ndryshimet kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij, e ka humbur statusin për shkak të dorëheqjes nga detyra që mbante dhe, për pasojë, procedura që do të zhvillohej ndaj tij *ex officio* duhej të ndërpritej duke u shoqëruar me aplikimin e pasojave të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Konstatohet se ky shkak ankimi është i lidhur në mënyrë integrale me thelbin e ankimit të subjektit të rivlerësimit, për pasojë do të analizohet në vijim në themel, por, pavarësisht kësaj, Kolegji konstaton se fakti që subjekti aktualisht ushtron i pandikuar nga kjo vendimmarrje e Komisionit funksionin si Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese, dëshmon se nuk jemi para një cenimi të së drejtës private në kuptim të veprimtarisë profesionale. Në këto kushte, rezulton se vendimi i Komisionit nuk e ka penguar subjektin të luajë një rol të rëndësishëm në sistemin e drejtësisë, si ai që aktualisht ushtron, si drejtuesi më i lartë i administratës në gjykatën më të rëndësishme dhe me ndikim në sistemin gjyqësor dhe jetën e të gjithë vendit. Lidhur me bazueshmërinë ligjore të këtij kufizimi të jetës profesionale të subjektit të rivlerësimit, Kolegji mban në konsideratë se masa e sanksionit është vendosur mbi bazën e aplikimit të një norme kushtetuese, në këtë rast neni G i Aneksit të Kushtetutës.

15.14 Në përfundim, për sa analizuar më sipër, Kolegji i gjen jo të bazuara në prova e në ligj pretendimet e subjektit të rivlerësimit për cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor.

16. Kolegji mori në analizë edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimmarrja e Komisionit nuk është e drejtë dhe është marrë në zbatim të gabuar të dispozitave të ligjit nr. 84/2016, për arsytet që janë cituar në pjesën hyrëse të këtij arsyetimi e do të analizohen në mënyrë të detajuar në vijim të tij.

16.1 Komisioni, lidhur me procesin e rivlerësimit të subjektit Eugen Papandile, ka konkluduar se: *Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji, për dorëheqje nga detyra e këshilltarit ligjor. Në këtë kuptim, trupi gjykues arrin në përfundimin se për sa kohë dorëheqja e subjektit të rivlerësimit përmbush kriteret e përcaktuara në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, atëherë pasoja juridike që i atribuohet situatës faktike të parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës do të duhet të zbatohet në tërësinë e saj, duke i kufizuar të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes nga detyra të subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure*



*administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.*

**16.2** Në ankim, subjekti pretendon se ka një vlerësim të gabuar të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, e cila, sipas tij, është dhënë jo për të shmangur procesin e rivlerësimit kalimtar, por për një zhvillim të mëtejshëm në karrierën e tij profesionale. Këtë pretendim, subjekti e argumenton me faktin se nëse Komisioni do të analizonte në mënyrë kronologjike ngjarjet do të konstatonte se interesi i tij për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese nuk ka lidhje me procesin e tij të rivlerësimit kalimtar, dhe se nuk ka vend të diskutohet se pranimi i këtij pozicioni ka qenë një mekanizëm për t’iu shmangur procesit të rivlerësimit kalimtar.

**16.3** Për një vlerësim sa më të plotë të këtij shkakut ankimi, Kolegji mori në analizë veprimet e kryera nga subjekti dhe organet kompetente në funksion të emërimit të tij në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese, duke konstatuar sa vijon:

- i.** Me kërkesën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2017, z. Eugen Papandile, i adreson Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese kërkesën e emërtuar “Kërkesë për punësim”, me anë të së cilës i shpreh interesin për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj gjykate, si dhe paraqet bashkëlidhur saj dokumentet e nevojshme për të provuar plotësimin e kriterëve ligjore të kërkuara në njoftimin e publikuar në hapjen e garës për këtë pozicion pune.
- ii.** Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.12.2017, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, u propozon mbledhjes së gjyqtarëve të kësaj gjykate kandidaturën e z. Eugen Papandile për t’u emëruar në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj gjykate.
- iii.** Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.12.2017, ka vendosur emërimin e z. Eugen Papandile në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj gjykate, duke përcaktuar hyrjen në fuqi të këtij vendimi më datë 01.01.2018.

**16.4** Sipas subjektit të rivlerësimit këto ngjarje për emërimin e tij në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese kanë ndodhur rreth 2 vjet para se të nisë procesi i tij i rivlerësimit nga Komisioni, që sipas subjektit daton më datë 02.07.2021, kur ai është njoftuar nga Komisioni për fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar.

**16.5** Nga pretendimet në ankim, vërehet se subjekti konsideron si moment që e bën atë subjekt rivlerësimi, në kuptim të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, momentin kur subjektet njoftohen për nisjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (pra, në këtë rast, datën 02.07.2021). Kolegji e gjen këtë pretendim të subjektit në kundërshtim me parashikimin e nenit 179/b të Aneksit të Kushtetutës, i cili konsideron si subjekte rivlerësimi, që do t’i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*, të gjithë ata që në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, me anë të ligjit nr. 76/2016, janë duke ushtruar funksionet listuar në nenin 197/b, pika 4 e Kushtetutës. Gjithashtu, jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit ka elaboruar<sup>3</sup> gjerësisht konceptin se kush konsiderohet subjekt rivlerësimi, në kuptim të

<sup>3</sup> Në vendimin e Kolegjit nr. 46/2022 (JR), datë 01.12.2022, Kolegji ka arsyetuar si vijon:

Kolegji vlerëson se neni 179/b i Kushtetutës, në lidhje me pikën 16, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, janë dy dispozitat që kanë përcaktuar rrethin e subjekteve që do t’i nënshtrohen rivlerësimit kalimtar, sipas ligjit të posaçëm nr. 84/2016. Për

nenit 179/b të Kushtetutës dhe të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 dhe se cili është momenti kur fitohet ky status që lidhet me kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016. Gjithashtu, Kolegji vëren se vetë z. Eugen Papandile, siç ka referuar vendimi i Komisionit, rezulton se ka dorëzuar<sup>4</sup> deklaratën *vetting*, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 për kontrollin e pasurisë, duke e konsideruar veten në momentin e dorëzimit të saj, si subjekt rivlerësimi. Në këtë kuptim, meqenëse momenti i hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të bëra me ligji nr. 76/2016, z. Eugen Papandile e ka gjetur në funksionin e këshilltarit ligjor të Gjykatës Kushtetuese ai plotëson kushtet, sipas nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, për t'u konsideruar subjekt rivlerësimit *ex officio*, kushte të cilat legjitimojnë Komisionin për të nisur procesin e rivlerësimit kalimtar ndaj tij. Pretendimi i subjektit se momenti që i jep atij statusin e subjektit të rivlerësimit përkon me nisjen efektive të procedurës administrative, gjendet i pambështetur ligjërisht.

**16.6** Në rastin objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit në Komision, por edhe në ankim, pretendon se në dallim me raste të tjera të ngjashme, ai nuk ka shprehur një vullnet të shkruar, të formalizuar në një dokument me anë të të cilit provohet se ai ka shprehur vullnetin e tij të pavesuar për t'u larguar nga funksioni i këshilltarit ligjor të Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar se ai ka shkuar në pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj gjykate, me anë të vendimit të mbledhjes së gjyqtarëve të kësaj gjykate.

**16.7** Komisioni, për të verifikuar këtë pretendim të subjektit<sup>5</sup>, me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 03.09.2021, i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese përcjelljen e të gjithë praktikës së emërimit të z. Eugen Papandile në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm. Gjykata Kushtetuese, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 10.09.2021, i ka përcjellë Komisionit këtë praktikë nga e cila rezulton se subjekti ka aplikuar me kërkesën dhe vullnetin e tij për pozicionin vakant të Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi përfundimtar i Mbledhjes së Gjyqtarëve, që e emëron atë në këtë funksion, është në përgjigje të një procedure të nisur me kërkesën e tij.

**16.8** Në analizë të sa më sipër, Kolegji konstaton se e gjithë situata e mësipërme faktike tregon qartazi se emërimi i z. Eugen Papandile në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm ka ardhur për shkak të shprehjes së tij të interesit për të kandiduar për këtë funksion, i cili, nëse do të kishte munguar, ai nuk do të ishte përfshirë në procedurën e kryer për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave (katër të tilla) dhe, për pasojë, nuk do të ishte përzgjedhur në këtë funksion. Nga mënyra se si paraqitet në ankim procesi i emërimit në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm duket sikur ai është produkt i vendimmarrjes së Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe jo vullnetit të subjektit, të cilën nuk kishte zgjidhje tjetër përveç ta pranonte. Sa përshkruar më lart, tregon se aktet e administruara në fashikullin e hetimi

---

*të arritur në konkluzionin nëse zj. B. duhej t'i nënshtruhej procesit të rivlerësimit dhe për t'i dhënë zgjidhje themelit të çështjes, Kolegji mori në analizë pikën 16, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, e cila referon në nenin 179/b të Kushtetutës. [...] Pasa e statusit të magistrates në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016, i jep asaj cilësinë e "magjistrates/gjyqtares" dhe e bën në mënyrë të drejtpërdrejtë subjekt të ligjit nr. 84/2016, që bie nën parashikimin e nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës.*

<sup>4</sup> Kolegji, me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 13.04.2023, të Komisionit, ka administruar deklaratën *vetting*, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, të plotësuar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij në cilësinë e personit të lidhur.

<sup>5</sup> I cili rezulton se është ngritur prej tij që në komunikimin e datës 21.07.2021 që ka pasur me Komisionin, në përgjigje të njoftimit që e informon për nisjen e procesit të tij të rivlerësimit dhe e fton të shprehet për qenien ose jo në konflikt interesi.

administrativ provojnë qartazi që ka qenë vullneti dhe dëshira e subjektit për t'u punësuar në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm, ajo që e ka iniciuar përfshirjen e tij në këtë procedurë dhe, po ashtu, mosndryshimi i këtij vullneti deri në përfundim të procedurës së përzgjedhjes ka mundësuar emërimin e tij në këtë funksion. Në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative, paraqitja prej z. Papandile e “Kërkesës për punësim”, për funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese, për të cilin kishte nisur procedura administrative e përzgjedhjes dhe emërimit, e klasifikon atë sipas përkufizimit të nenit 3<sup>6</sup> dhe parashikimeve të nenit 3/b të Kodit të Procedurave Administrative si palë në procedurën administrative dhe, për pasojë, e vendos vullnetin e tij si një prej kushteve të përfundimit të vetë procedurës administrative.

**16.9** Për më tepër, nëse puna/detyra që ka kryer z. Eugen Papandile, pas vendimit të Mbledhjes së Gjyqtareve, do të kishte qenë në kundërshtim me vullnetin e tij, atëherë duket se subjekti ka pranuar të kryejë një detyrë duke cenuar lirinë e tij për punë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 26 të Kushtetutës, sipas së cilit askujt nuk mund t'i kërkohet kryerja e një pune të detyruar përveçse në rastet e përcaktuara në këtë dispozitë.

**16.10** Nga sa evidentuar më sipër, Kolegji konstaton se emërimi i z. Eugen Papandile, në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese, ka qenë një dëshirë dhe vullnet i subjektit i finalizuar në një kërkesë zyrtare së bashku me paraqitjen e një sërë dokumentesh në mbështetje të saj. Kjo situatë vlerësohet nga Kolegji se tregon qartazi për vullnetin e pavesuar të subjektit për t'u emëruar në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm, të ndryshëm nga funksioni i këshilltarit ligjor që ai mbante. Në këtë kuptim, ashtu si edhe Komisioni, Kolegji konsideron se veprimet e subjektit, për t'u emëruar në detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë të qartë dhe të logjikshme tregojnë edhe vullnetin e tij për të lënë funksionin e këshilltarit ligjor pranë kësaj gjykate, funksion të cilin nuk mund ta mbante njëkohësisht me atë për të cilin kishte aplikuar. Subjekti i rivlerësimit në këtë rast ka ushtruar të drejtat e tij duke bërë një zgjedhje personale mes dy funksioneve që shtroreshin para tij si opsione punësimi, duke hequr dorë nga ushtrimi i funksionit që i jepte atij statusin e subjektit të rivlerësimit për të ushtruar funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese. Duke e zhveshur veten nga funksioni i parë, subjekti ka zgjedhur *ispo jure* të ketë si konsekuencë edhe pasojën ligjore që parashikon neni G i Aneksit të Kushtetutës. Pretendimi i subjektit se ai nuk ka dhënë dorëheqje nga pozicioni i Këshilltarit Ligjor, zhvlerësohet si i tillë, kur nga aktet rezulton se subjekti ka ndërmarrë një sërë veprimesh që dëshmojnë se ai është përfshirë në procedura rekrutimi për pozicione të tjera pune, i vetëdijshëm se emërtimi i tij në funksion për të cilin konkurrenonte në mënyrë automatike passillte largimin nga funksioni i këshilltarit ligjor. Këtë fakt e dëshmojnë aktet si “kërkesa për punësim”, në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese, e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, në funksion të së cilës (sipas përmbajtjes së

---

<sup>6</sup> Në nenin 3 të Kodit të Procedurës Administrative të emërtuar “përkufizime” përcaktohet se:

7 “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi; ose

b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës.

8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.

njoftimit të publikuar për këtë vend pune), subjekti duhet t'i jetë nënshtruar një provimi me shkrim dhe një interviste pune, si dhe ka paraqitur edhe një platformë<sup>7</sup> personale të qëllimeve dhe objektivave që propozon të ndjekë nëse zgjidhet në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm.

**16.11** Në përfundim të sa analizuar më sipër, si dhe në konsideratë të qëndrimit të vendimit nr. 21/2022 (JR)<sup>8</sup>, datë 17.06.2022, të Kolegjit, duke pasur juridiksionin e posaçëm dhe të vetëm për të përcaktuar kualifikimet ligjore për çështjet që i përkasin procesit të rivlerësimit, juridiksion i cili lejon Kolegjin që të përcaktojë ligjërisht çdo rrethanë fakti nën parashikimet e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, pavarësisht trajtimit apo interpretimit që u japin atyre subjektet apo persona të tretë, Kolegji vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit se pjesëmarrja e subjektit në garën e hapur për vendin vakant të Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese duhet të barazohet me shfaqjen e një vullneti të qartë për t'u dorëhequr nga funksioni i këshilltarit ligjor, pranë të njëjtës gjykatë. Mungesa e një akti formal që përfaqëson këtë vullnet nuk vë në dyshim ekzistencën e tij dhe as shmang pasojat që procesi i rivlerësimit i jep shfaqjes së këtij vullneti, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

**16.12** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se duhet të mbahet në konsideratë fakti që moskryerja prej subjektit e testimin nga Shkolla e Magjistraturës nuk është për faj të tij, por për shkak se në momentin kur janë kryer këto teste ai nuk është konsideruar subjekt në detyrë dhe nuk është njoftuar për këtë testim nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe duke pretenduar se për vlerësimin profesional ai i është nënshtruar vlerësimit të një organi tjetër Kushtetues dhe, për pasojë, Komisioni gjendet para gjësë së gjykuar, Kolegji analizon sa vijon.

**16.13** Nga aktet e administruara në fashikullin e hetimit administrativ, rezulton se Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. {\*\*\*} port., datë 15.09.2021, ka informuar Komisionin se z. Eugen Papandile nuk ka aplikuar dhe as ka marrë pjesë, edhe për shkak të zgjedhjes së tij personale, në provimin e testimin të aftësive profesionale të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës. Marrja e kësaj përgjigje ka bërë që Komisioni të gjendet në mungesë të raportit të vlerësimit të aftësive profesionale të kërkuar nga neni 42 i ligjit nr. 84/2016. Komisioni këtë fakt ia ka bërë me dije subjektit, i cili ka pretenduar se duke pasur statusin e Sekretarit të Përgjithshëm, grada më lartë e statusit të nëpunësit civil, nuk mund të merrte pjesë në testimin e Shkollës së Magjistraturës, për këtë arsye objekti për të cilin Komisioni duhet të nisë punën bëhet i pamundur. Në ankim, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, subjekti parashtron se Kolegji duhet të konsiderojë se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar kontrollit të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale nga KED-ja që, gjithashtu, është një organ kushtetues i pavarur, pretendim i cili do të analizohet në vijim.

---

<sup>7</sup> *Informacion, i cili evidentohet në relacionin e datës 07.12.2017, të Drejtorisë Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore pranë kësaj gjykate drejtuar Kryetarit të kësaj gjykate.*

<sup>8</sup> *Në këtë vendim, Kolegji ka arsyetuar se: Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e tij, sipas së cilës, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, vullneti i subjekteve për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit, shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Në momentin që subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij të lirë, ndërpret detyrën funksionale, që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit, ex officio, duhet të marrë parasysh edhe pasojën ligjore që sjell dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës shih [https://kpa.al/wpcontent/uploads/2022/09/Vendim\\_Selami\\_Zalli\\_perfshire\\_pakicen\\_anonimizuar.pdf](https://kpa.al/wpcontent/uploads/2022/09/Vendim_Selami_Zalli_perfshire_pakicen_anonimizuar.pdf)*

**16.14** Arsyetimi i përdorur nga subjekti se Shkolla e Magjistraturës nuk e ka njoftuar për testimet, pasi në kohën e kryerjes së tyre, maj 2018, ai nuk ushtronte më funksionin e këshilltarit ligjor, gjendet nga Kolegji si jo i drejtë dhe i pabazuar ligjërish, pasi referuar parashikimit të pikës 4, të nenit 42 të ligji nr. 84/2016, testimin e Shkollës së Magjistraturës nuk e kryenin vetëm këshilltarët ligjor në detyrë, por edhe ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, që kishin ushtruar për jo më pak se 3 vjet këtë funksion. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji konstaton se në ankim subjekti i rivlerësimit nuk bën asnjë shpjegim përse nuk e ka konsideruar mundësinë e kryerjes së testimit nga Shkolla e Magjistraturës si ish-subjekt, veprim, i cili, gjithashtu, do të kishte dëshmuar për ekzistencën e vullnetit të subjektit për t'u vetuar në funksion të rivlerësimit kalimtar, të cilën në ankim ai më së shumti e lakon/cilëson si një vullnet që nuk ka munguar.

**16.15** Lidhur me pretendimin e subjektit se rivlerësimi i tij si ish-këshilltar i Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të bëhet nga Komisioni, pasi tashmë kjo ishte gjë e gjykuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, që është një organ tjetër kushtetues i pavarur, duke pretenduar se Komisioni nuk ka pasur kompetencë dhe juridiksion për të kryer procesin e tij të rivlerësimit kalimtar, Kolegji analizon sa vijon.

**16.16** Lidhur me këtë shkak ankimi në vendimin e Komisionit është konkluduar se *në analizë të sa më sipër, Komisioni çmon se nuk është ezauruar juridiksioni dhe kompetenca nga KED-ja për rivlerësimin e z. Eugen Papandile në kuptim të kriterëve të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.*

**16.17** Ky pretendim i subjektit, i ngritur si para Komisionit, ashtu edhe në ankim, ashtu siç shprehet në vendimin e Komisionit<sup>9</sup> objekt shqyrtimi, buron/vjen nga fakti që KED-ja, në rastin e kandidimit të z. Eugen Papandile, ka pranuar t'ia nënshtrojë vlerësimit të saj këtë kandidaturë pa pritur që për të të përfundojë procedura e rivlerësimit kalimtar nga Komisioni, procedurë të cilën e ka zbatuar për kandidatura të tjera.

**16.18** Në drejtim të identifikimit të parashikimeve ligjore, lidhur me kompetencat e organeve të rivlerësimit dhe të KED-së, konstatohet se neni 197/b i Kushtetutës dhe neni 4 i ligjit nr. 84/2016, përcaktojnë në mënyrë të plotë arsyet e nisjes së procesit të rivlerësimit kalimtar, duke synuar, ndër të tjera, kthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, përcaktojnë organet kompetente që do të kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar, duke identifikuar si të tilla Komisionin, Komisionerin Publik dhe Kolegjin e Posaçëm të Apelit, përcaktojnë subjektet që *ex officio* i nënshtrohen këtij procesi, si dhe evidentojnë pasojat e moskalimit me sukses të tij.

**16.19** Ndërsa, në një tjetër drejtim, në atë të legjitimitetit të ngritjes së organeve të reja të drejtësisë, neni 149/d i Kushtetutës, lidhur me KED-në, parashikohet se: *Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati.*

---

<sup>9</sup> Në vendimin e Komisionit në paragrafin 12.2, ndër të tjera, arsyetohet se: *Po në raste në lidhje me kalimin me sukses të kriterit të pasurisë për kandidatët, të cilët kanë qenë subjekte të rivlerësimit kalimtar të ngjashme (edhe ish-këshilltarë të Gjykatës Kushtetuese) KED-ja ka pritur përfundimin e hetimit të Komisionit.*

**16.20** Nga këto përcaktime kushtetuese dhe ligjore të kompetencave të organeve të rivlerësimit dhe ato të KED-së, konstatohet se ato janë të ndryshme, pasi organet e rivlerësimit kanë si qëllim rivlerësimin kalimtar, duke u bazuar në kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, pasi kalimi me sukses i kontrollit të këtyre tri kriterëve mundëson konfirmimin në detyrë të subjekteve të rivlerësimit, ndërsa KED-ja ka si kompetencë kryesore të verifikojë plotësimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve morale e profesionale të kandidatëve, me qëllim zgjedhjen si anëtar të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “ILD”) apo Gjykatës Kushtetuese, kandidatë të cilët, jo domosdoshmërisht janë edhe subjekte rivlerësimi. Gjithashtu, duhet konsideruar se nivelet e kontrollit të aftësive profesionale, në kuptim procesit të rivlerësimit dhe të atij të kryer nga KED-ja janë të ndryshme, pasi ky i fundit këtë verifikim e bazon kryesisht në plotësimin e kriterëve ligjore për kandidatët lidhur me vitet e kërkuara si eksperiencë pune, pasjen e masave disiplinore në fuqi dhe në vlerësimin e konkluzioneve të organeve të tjera, pa ia nënshtruar këtë verifikim një hetimi të gjithanshëm siç veprojnë organet e rivlerësimit.

**16.21** Kolegji, në vijim të analizës së këtij shkakut ankimi, duke iu referuar vendimeve nr. 35/2020 dhe 36/2020, të KED-së, vëren se nga ky organ verifikimi i pasurisë së z. Eugen Papandile është bazuar vetëm në administrimin e raportit nga ILDKPKI-së, sipas së cilit subjekti ka bërë një deklaram të saktë të pasurisë pa vijuar me një hetim e vlerësim të tij mbi këtë kriter.

**16.22** Kolegji konstaton se e njëjta situatë paraqitet edhe me vlerësimin e aftësive profesionale të z. Eugen Papandile, të cilat, sipas vendimeve nr. 35/2020 dhe 36/2020, të KED-së, janë vlerësuar nën fokusin e plotësimin të viteve të punës së kërkuar për pozicionin, si dhe nëse kjo eksperiencë i përmbush kërkesat ligjore. Ndërkohë, në funksion të procesit të rivlerësimit, Komisioni për subjektet, përveçse administron raportin e kontrollit të strukturës përgjegjëse (KLP apo KLGj), merr në analizë të detajuar punën e subjektit të kryer në tri vitet e fundit nga momenti i fillimit të procesit të rivlerësimit, duke konsideruar që në funksion të vlerësimit të aftësive profesionale një rol me rëndësi luan edhe verifikimi i denoncimeve nga publiku që administrojnë organet e rivlerësimit.

**16.23** Në përfundim, *lidhur me pretendimin e subjektit se procesi i tij i rivlerësimit nuk mund të kryhej nga Komisioni sepse ai ishte kryer nga një organ tjetër kushtetues, siç është Këshilli i Emërimeve në Drejtësi*, Kolegji vlerëson se mbetet pa relevancë në zgjidhjen e çështjes, për sa kohë që neni 179/b i Kushtetutës dhe neni 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, përcakton se subjektet e rivlerësimit, siç është edhe ankuesi, i nënshtrohen *ex officio* procesit të rivlerësimit që kryejnë organet e rivlerësimit, pa u ndërvarur ky proces nga asnjë procedurë tjetër e ngjashme apo paralele që mund të kryhet nga organe të tjera kushtetuese. Për më tepër, procesi i vlerësimit i pretenduar prej subjektit se është kryer ndaj tij prej KED-së është përmbyllur me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.11.2020, nëpërmjet të cilit është vendosur *për ndalimin e kandidimit të z. Eugen Papandile në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës më datë 22.11.2019.*

**16.24** Kolegji, gjithashtu, mori në analizë edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit *se në asnjë rast nuk është shprehur se nuk duhet të vetohet, dhe se në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi nuk është pasqyruar vullneti i tij për të vazhduar procesin e rivlerësimit, për të cilin ka konstatuar sa vijon:*

**16.25** Në vendimin e Komisionit, lidhur me shprehjen e vullnetit nga subjekti i rivlerësimit për t'u vetuar nga ky organ, është pasqyruar sa vijon:

*Po në datën 07.07.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua nëpërmjet postës elektronike mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, duke iu dërguar edhe pyetëtori standard. Në përgjigje të e-mail-it të dërguar në datën 28.7.2021, subjekti nuk i është përgjigjur pyetësit standard, duke përcjellë një kërkesë, në të cilën parashtron pretendimet e tij për t'u mos iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke theksuar se procesi i rivlerësimit ndaj tij duhet të ndërpritet, pasi në kushtet aktuale nuk është më subjekt i rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës [...] Si përfundim, subjekti ka shprehur bindjen se rivlerësimi kalimtar si ish-këshilltar i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të bëhet, pasi tashmë kjo është një gjë e gjykuar, si dhe Komisioni nuk ka tashmë kompetencë apo juridiksion për ta bërë këtë gjë. E kundërta, sipas pretendimeve të subjektit, do të ishte cenim i shumë parimeve kushtetuese, për më tepër cenim i sigurisë juridike. Subjekti citon: “Nuk mundet që unë të bëj sa herë të më kërkohet rivlerësim pafund (të paktën deri në datën kur ka marrë formë të prerë), si nga Gjykata e Apelit Administrativ (nr. {\*\*\*}, datë 2.12.2020<sup>10</sup>) apo vendimi përfundimtar i KED-së (nr. {\*\*\*}, datë 23.11.2020)”.*

**16.26** Në ankim subjekti ngre pretendimin se prej tij nuk ka pasur në asnjë moment në Komision ndonjë kërkesë për të mos u vetuar, siç arsyeton Komisioni, dhe se ka parashtruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për faktet e ndodhura bazuar mbi sjelljen e organeve kushtetuese të përfshira në procesin e verifikimit të subjekteve që shprehin interes për të kandiduar për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu, subjekti pretendon se me veprime konkludente, duke kandiduar për t'u emëruar gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, ka kërkuar t'i nënshtrohet verifikimit dhe kontrollit të tri kriterëve, ndaj nuk mund të arrihet në një përfundim të kundërt.

**16.27** Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, Kolegji vëren se situata faktike, lidhur me vullnetin e shprehur nga subjekti për t'u vetuar nga Komisioni, përmbledhet në situatat e mëposhtme:

- i.** Subjekti që me komunikimin e parë me e-mail, më datë 21.07.2021, i paraqet qëndrimin e tij Komisionit lidhur me nisjen e procesit të rivlerësimit duke pretenduar se nuk ndodhet në kushtet aktuale si “subjekt i rivlerësimit kalimtar” në përputhje me parashikimet e nenit 197/b të Kushtetutës.
- ii.** Subjekti nuk shprehet lidhur me qenien e tij në kushtet e konflikti të interesit me anëtarët e trupës së Komisionit dhe as plotëson pyetësin standard nr.1, të kërkuar nga Komisioni.
- iii.** Gjithashtu, të gjithë kërkimet që subjekti ngre para Komisionit bazohen në pretendimin që ky organ nuk ka kompetencë ta vetojë atë, pasi një organ tjetër e ka vetuar tashmë, qëndrim ky, i cili, përsëritet edhe me ankimin.

**16.28** Në analizë të këtyre elementëve, Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit edhe pse shprehet se nuk ka deklaruar asnjëherë vullnetin për të mos u vetuar, me qëndrimet kontradiktore të mbajtura, sjelljen dhe veprimet e kryera duke mos plotësuar pyetësin standard dhe duke mos u deklaruar mbi ekzistencën apo jo të konfliktit të interesit, ka pamundësuar vijimin e procesit të rivlerësimit nga Komisioni.

---

<sup>10</sup> Në vendimin e KED-së nr. {\*\*\*}, vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit referohet me nr. {\*\*\*}, datë 06.11.2020.

16.29 Në përfundim, lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në asnjë rast nuk është shprehur se nuk duhet të vetohet, dhe se në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi nuk është pasqyruar vullneti i tij për të vazhduar procesin e rivlerësimit, Kolegji konstaton se vullneti i shprehur i subjektit përgjatë hetimit administrativ, por edhe në ankim lidhet vetëm me nënshtrimin prej tij ndaj procesit të vlerësimit që ka kryer KED-ja. Vullneti i subjektit, për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit prej organeve të rivlerësimit, nuk është i evidentuar për sa kohë që subjekti pretendon se Komisioni nuk ka pasur as juridiksion dhe as kompetencë për të kryer këtë proces dhe as është sjellë gjatë hetimit në përputhje me këtë pretendim. Kërkimi përfundimtar i subjektit në ankim mbetet i pambështetur nga e gjithë boshti dhe arsyetimi ligjor e logjik i ankimit të tij, për pasojë Kolegji ka të njëjtin vlerësim si Komisioni se ky nuk është vullneti i vërtetë i subjektit të rivlerësimit.

16.30 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nisur nga specifikat e rastit të tij subjekti pretendon se humbja e statusit si subjekt rivlerësimi duhej të trajtohej sipas nenit 95 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, Kolegji vlerëson se nuk gjendemi para situatës faktike që mund të kualifikohet sipas këtij pretendimi. Në këto rrethana, sillet në vëmendje qëndrimi i mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit<sup>11</sup>, sipas së cilit, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, vullneti i subjekteve për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Në momentin që subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij të lirë, ndërpret detyrën funksionale, që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit, *ex officio*, duhet të marrë parasysh edhe pasojën ligjore që sjell dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Në këto kushte, parashikimi i nenit 95 të ligjit nr. 45/2016 është i pamundur të zbatohet.

17. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se humbja e statusit të subjektit të rivlerësimit me vullnetin e tij, si një zgjedhje personale, pavarësisht motiveve dhe qëllimeve që e shtyjnë atë drejt këtij akti, e bën të pamundur vijimin e këtij procesi të rivlerësimit edhe në kushtet kur subjekti do të kërkonte t'i nënshtronte atij, duke qenë se ndërprerja e procesit dhe vendosja e ndalimit të parashikuar nga neni G i Aneksit të Kushtetutës, konsiderohet si alternativë imperative dhe e vetme për zbatim në rastet e humbjes së statusit për shkak të dorëheqjes.
18. Në përfundim, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Kolegji e gjen të mbështetur në fakte e në ligj vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi e, për pasojë, çmon se ai duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupit gjykues, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

---

<sup>11</sup> Shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 21/2022 (JR)<sup>11</sup>, datë 17.06.2022, të përfshirë në poshtëshënimin nr. 8 të këtij vendimi.



**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 591, datë 23.11.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Eugen Papandile.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 19.04.2023.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi -kundër*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues për shqyrtimin e çështjes (JR) nr. 5/2023, datë 03.02.2023, kam votuar kundër vendimit të shumicës, për lënien në fuqi të vendimit nr. 591, datë 23.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që i përket subjektit të rivlerësimit Eugen Papandile.
2. Në cilësinë e gjyqtares në pakicë, në vijim të qëndrimit tim në jurisprudencën e Kolegjit, çmoj se arsyetimi i shumicës së trupit gjykues në vendim është i gabuar me pasojë një vendimmarrje në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore. Këtë vlerësim, e mbështes në arsyetimin më poshtë.
  - 2.1. Në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, subjekti i rivlerësimit Eugen Papandile ka ushtruar funksionin e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese dhe bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe nenin 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, ndaj tij ka nisur procesi i rivlerësimit *ex officio* prej Komisionit.
  - 2.2. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar dhe nënshtruar debatit gjyqësor në dhomë këshillimi, ka rezultuar e provuar se subjekti i rivlerësimit me kërkesën për punësim të datës 30.10.2017, drejtuar Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, ka shprehur interes për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj gjykate. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.12.2017, ka vendosur emërimin e z. Eugen Papandile në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj gjykate, hyrë në fuqi më datë 01.01.2018. Këtë funksion, subjekti i rivlerësimit e ushtron aktualisht.
3. Në këtë situatë faktike e ligjore, në zbatim të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, subjekti i rivlerësimit Eugen Papandile, duhet t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit ose në të kundërt, sipas parashikimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, të kërkonte nëpërmjet dorëheqjes ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, me pasojë ndalimin e emërimit të tij si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
4. Unë gjyqtare në pakicë e kundërshtoj konkluzionin e shumicës së trupit gjykues, që *vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit se pjesëmarrja e subjektit në garën e hapur për vendin vakant të Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese, duhet të barazohet me shfaqjen e një vullneti të qartë për t’u dorëhequr nga funksioni i këshilltarit ligjor pranë të njëjtës gjykatë. Mungesa e një akti formal që përfaqëson këtë vullnet nuk vë në dyshim ekzistencën e tij dhe as shmang pasojat që procesi i rivlerësimit i jep shfaqjes së këtij vullneti, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.*
5. Qëndrimin tim kundër këtij konkluzioni e argumentoj mbështetur në nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës, se procesi i rivlerësimit, si në Komision, ashtu edhe në Kolegji, do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit.
6. Në ankimin paraqitur në Kolegji, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar qartazi *prishjen e vendimit të Komisionit dhe lënien në çmim të gjykimit përfundimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për pushimin e gjykimit dhe ndërprerjen e procesit të rivlerësimit apo vazhdimin e rivlerësimit dhe hetimit administrativ.*

7. Referuar shkaqeve të ankimit dhe kërkimin përfundimtar në këtë ankim, dal në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Eugen Papandile *kërkon rivlerësim dhe hetim administrativ nga institucionet e rivlerësimit*. Nuk konstatoj ndonjë paqartësi në kërkimin e subjektit sikurse pretendon shumica në vendim e, për këtë arsye, jam në opionencë të plotë me konkluzionin e shumicës se duke shprehur interes për një detyrë tjetër, automatikisht ke shprehur edhe vullnetin për t'iu shmangur procesit të rivlerësimit. Vlerësoj se procesi i rivlerësimit nuk pengon subjektet e rivlerësimit për të gëzuar të drejtën e vijimit të karrierës së tyre në detyra të ndryshme, por penalizon ata, në ato raste kur ndryshimi i funksionit bëhet vetëm me qëllimin e shmangies nga procesi i rivlerësimit. Rasti objekt shqyrtimi, jo vetëm që nuk ndodhet në këto kushte, por ka lënë në çmim të Kolegjit të vendosë edhe për *vazhdimin e rivlerësimit dhe hetimin administrativ*.
8. Përderisa nuk është disponuar me një vendim përfundimtar për çështjen, në këtë fazë të gjykimit, subjekti i rivlerësimi ka pasur të drejtë t'i kërkojë gjykatës t'i nënshtrohet rivlerësimit kalimtar, të drejtë të cilën e ka ushtruar nëpërmjet ankimit në Kolegj. Mbështes këtë argument edhe në parashikimin kushtetues që ligjvënësi jo pa qëllim ka përcaktuar se procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet.
9. Gjykoj se mënyra sesi ka arsyetuar shumica e trupit gjykues lidhur me çështjen, nuk mbron aspak të drejtat e subjektit të rivlerësimit në këtë proces, pasi ka gjurmuar me saktësi hapat e ndërmarrë nga subjekti i rivlerësimit, por ka mbyllur sytë në kërkimin e tij përfundimtar në ankim për t'u vetuar nga institucionet e rivlerësimit.
10. Në vlerësimin tim, në rastin objekt shqyrtimi nuk gjejnë vend për zbatim parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka përdorur dorëheqjen nga detyra si mjet për t'iu shmangur procesit të rivlerësimit, për më tepër kur ai ka shprehur disponibilitetin për t'iu nënshtrohet atij. Në përfundim, çmoj se shumica e trupit gjykues duhet të kishte disponuar me prishjen e vendimit të Komisionit, sipas parashikimit të nenit 66, pika 1, germa "c" e ligjit nr. 84/2016, për të vijuar me procesin e rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit Eugen Papandile.

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*